

**HASAN BELLO****KISHA KATOLIKE NË VITET  
E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE****Abstrakt:**

*Në këtë artikull pasqyrohet qëndrimi i klerit dhe i Kishës Katolike Shqiptare gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Ai synon të paraqesë një panoramë mbi raportet e këtij entiteti fetar me administratën e Italisë fashiste dhe pas kapitullimit të saj, me atë të Gjermanisë naziste. Ai synon të sqarojë disa pika delikate të këtyre marrëdhënieve, që kushtëzoheshin nga kushtet e rënda të pushtimit dhe forcave ushtarake që vepronin në kuadër të luftës, duke i shqyrtuar e analizuar ato rast pas rasti me të gjitha nuancat e qëndrimet individuale të personaliteteve më eminente të klerit katolik.*

**Fjalë kyçe:**

Kleri, kisha katolike, Lufta e Dytë Botërore, marrëdhëniet me administratën kuislinge

**Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit italian (1939-1943)**

Pushtimi italian u prit me entuziazëm të madh nga disa qarqe katolike. Për këtë ndikuan shumë faktorë, duke nisur që nga raportet e tensionuara të kishës dhe klerit me Mbretin Zog; interesat politike dhe ekonomike me një shtet të fuqishëm si Italia dhe kujdesi që kjo e fundit kishte treguar ndaj pakicës katolike si protektore dhe zëvendësuese e Austro-Hungarisë. Revista “Hylli i Dritës” e konsideroi 7 prillin si fillimin e një “epoke të re” e “fatbardhë” për popullin shqiptar. Në faqet e saj kritikohet regjimi i mëparshëm i Mbretit Zog dhe himnizohet vendimi i Asamblesë kuislinge për bashkimin e Shqipërisë me Italinë.<sup>1</sup> Kjo revistë u vendos në shërbim të propagandës së regjimit të ri, duke botuar statutin e Partisë Fashiste Shqiptare,<sup>2</sup> dekretligjin për krijimin e milicisë<sup>3</sup> apo

<sup>1</sup> “Lajme rrokull Shqypnis”, *Hylli i Dritës*, nr. 3-7, Shkodër, 1939, f. 358-366.

<sup>2</sup> “Statuti i Partisë Fashiste Shqiptare”, *Hylli i Dritës*, nr. 8-10, Shkodër, 1939, f. 474-488.

duke himnizuar vendosjen e kryqit të liktorit në flamurin shqiptar.<sup>4</sup> Drejtori i saj at Gjergj Fishta me rastin e 40-vjetorit të fronëzimit të Vittorio Emanuele-t III si Mbret i Italisë, i Shqipërisë dhe si Perandor i Etiopisë i dërgoi një telegram urimi.<sup>5</sup> Në një artikull për “Rivista d’Albania” të Akademisë Mbretërore të Italisë ai glorifikoi lulëzimin e popullit shqiptar nën Perandorinë Romake, duke aluduar hapur se e njëjta gjë do të ndodhte edhe nën regjimin fashist.<sup>6</sup>

Episkopati katolik i Shqipërisë i dërgoi Vittorio Emanuele-t III një telegram ku i shprehte gëzimin e sinqertë për bashkimin personal të dy kurorave, që sipas tij siguronte ekzistencën kombëtare dhe përparimin fetar, kultural dhe ekonomik të Shqipërisë. Telegrami nënshkruhej prej argjipeshkvit të Shkodrës dhe Durrësit dhe peshkopëve të Pultit, Lezhës, Sapës dhe Mirditës.<sup>7</sup> Në avangardë të klerikëve që u vendosën në shërbim të makinerisë ushtarake dhe propagandistike të Italisë fashiste ishte dom Lazër Shantoja, i cili u dërgua nga Drejtoria e Përgjithshme e Shtypit dhe Propagandës në Kajro si korrespondent i gazetës “Tomori” për të mbajtur një cikël ligjëratash radiofonike dhe takimesh në koloninë shqiptare të Egjiptit.<sup>8</sup> Ai përkujtoi krijimin e degës së Fashios Shqiptare në Kajro dhe vlerësoi përfitimet që do të kishte Shqipëria dhe shqiptarët nga bashkimi i tyre me Italinë.<sup>9</sup> Sipas legatës italiane në Aleksandri oratoria dhe influenca personale e dom Lazër Shantojës do të kishte rrjedhoja të konsiderueshme dhe efikase në mjediset shqiptare.<sup>10</sup>

Gjithashtu në funksionin e drejtorit të Institutit “Dante Aligeri”, ai do të zhvillojë një veprimtari intensive në shërbim të fashizmit, duke propaganduar se populli shqiptar nuk e kishte humbur pavarësinë pas 7

<sup>3</sup> “Krijimi i Milicjes Fashiste Shqiptare”, *po aty*, f. 489-494.

<sup>4</sup> Marin Sirdani, “Dita e flamurit”, *Hylli i Dritës*, nr. 11-12, Shkodër, 1939, f. 611-620.

<sup>5</sup> “Telegram urimi i M.T. Mbret e Perandor Victor Emanuelit III drejtorit tonë”, *Hylli i Dritës*, nr. 7-9, Shkodër, 1940, f. 297-488.

<sup>6</sup> Gjergj Fishta, “Lulzimi i popullit shqiptar ndënë Perandorinë Romake”, *Bota e Re*, nr. 9, Tiranë, 28 shtator 1940, f.1, 8.

<sup>7</sup> “Kleri katolik i Shqipërisë përgëzon Mbretin Perandor”, *Shtypi*, nr. 586, Tiranë, 27 maj 1939, f.1.

<sup>8</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 161, Viti (më tej: V.) 1940, Dosja (më tej: D.) 76, fl.6. Telegram i Zenone Beninit për Mëkëmbësin e Përgjithshëm Francesco Jacomoni, 8 mars 1940.

<sup>9</sup> “Konferenca e Dom Lazër Shantojës”, *Tomori*, nr. 60, Tiranë, 30 prill 1940, f.1.

<sup>10</sup> *AQSH*, F.161, V.1940 D.76, fl.11. Telegram i konsullatës italiane në Aleksandri për Mëkëmbësin e Përgjithshëm, Francesco Jacomoni, Aleksandri, 5 prill 1940.

prillit dhe duke himnizuar favoret që do të vinin nga pushtimi italian.<sup>11</sup> Por kishte dhe klerikë që shprehën njëfarë kundërshtimi për të bashkëpunuar me Italinë. Pesë ditë pas pushtimit, në mbledhjen e organizuar në shtëpinë e prijësit katolik të Mirditës, Gjon Marka Gjonit, i cili nuk dëshironte të ndërmerre asnjë hap pa mbështetjen e klerit katolik ishin të pranishëm at Anton Harapi dhe përfaqësuesi i argjipeshkvit dom Mikel Koliqi. Për arsye se Gjon Marka Gjoni shprehu gadishmërinë për të bashkëpunuar me Italinë, at Anton Harapi deklaroi: “Çuditem për ju, more burra, se ne na keni thirrë vetëm kur asht puna me vorrue të vdekunit”<sup>12</sup>. Sipas Donat Kurtit, Harapi u tregua një përfaqësues i shkëlqyer i interesave të shqiptarëve kundër aneksimit italian. Pak kohë më vonë gjatë bisedimeve zyrtare në Tiranë në praninë e ministrit të Jashtëm, kontit Ciano (Çiano) dhe Francesco Jacomoni-t (Francësko Jakomoni), Harapi do të këmbëngulë për një deklaratë për pavarësinë e Shqipërisë dhe një bashkim të mirëfilltë të dy mbretërive, siç ishte rasti i Irlandës me Anglinë. At Anton Harapi ishte nga të paktët klerikë që tregoi një rezistencë të hapur ndaj Italisë. Kjo bëri që brenda një kohe të shkurtër të fillonin përpjekjet për largimin e tij nga Kuvendi me qëllim që gjimnazit françeskan t'i krijonin pengesa lidhur me programin dhe organizimin shkollor. Por krahas at Anton Harapit nuk munguan edhe emra të tjerë që u pozicionuan kundër fashizmit. Kështu, Athanas Gegaj OFM, Gjon Shllaku OFM dhe dom Lek Luli u burgosën ose u dëbuan nga vendi. Aktivitetet e rinisë antoniane u penguan nga sekuestrimi i instrumenteve muzikorë. Për të qetësuar disi situatën gjenerali françeskan dërgoi nga Roma një ndërmjetës, i cili i këshilloi etërit françeskanë që të ishin më të kujdesshëm. Për të eliminuar paragjykimet ndaj Italisë, në Romë u dërguan për të studiuar edhe disa seminaristë.<sup>13</sup>

Delegati apostolik, Leone Nigris mendoi të përfitonte nga rrethanat e krijuara për të nënshkruar një Konkordat, për të cilin mes Shqipërisë dhe Vatikanit ishin zhvilluar tratativa që në vitet 20-30-të.<sup>14</sup> Për këtë, më 1 tetor 1939 ai i dërgoi një letër Mëkëmbësit të Përgjithshëm, F. Jacomoni-t.

<sup>11</sup> Lazër Shantoja, *L'Albania nel quadro dell'Impero di Roma/Shqipëria në kuadrin e Perandorisë Romake*, Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Shtypit, 1939, f.7.

<sup>12</sup> Markus W.E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri (1919-1996)*, Lezhë: Gjergj Fishta, 2010, f.116.

<sup>13</sup> *Po aty*.

<sup>14</sup> Hasan Bello, *Shqipëria, Kisha katolike dhe Vatikanit (nga fundi i shek. XIX - 1939)*, ASA-Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2019, f. 145-169.

Por duke pasur parasysh se Shqipëria nuk gëzonte sovranitet, autoritetet italiane nuk shprehën asnjë pikëpamje zyrtare lidhur me këtë kërkesë.<sup>15</sup>

Në aspektin material bashkimi i Shqipërisë me Italinë për kishën dhe klerin katolik pati shumë anë pozitive.<sup>16</sup> Kjo për shkak se një nga mjetet për të mikluar klerin dhe për të siguruar mbështetjen e besimtarëve katolikë shqiptarë ishte subvencionimi dhe furnizimi i tyre me ndihma. Një dhuratë jashtëzakonisht të bukur katolikët e Tiranës e morën me rastin e Krishtlindjeve të vitit 1939. Kjo dhuratë ishte kisha e Zemrës së Krishtit në bulevardin “Mussolini” (sot Rruga e Kavajës), arkitekt i së cilës ishte prof. Giovanni Santi. Altari i kishës ishte dhuratë e Atit të Shenjtë, dritaret iu dhuruan jezuitëve nga kontesha Maja Jacomoni di San Savino, bashkëshortja e Mëkëmbësit, ndërsa ikonostasin për altarin e ritit ortodoks e dhuroi avokati Terenc Toçi.<sup>17</sup>

Qeveria italiane u tregua e kujdesshme. Ajo nuk dëshironte të tregonte në sytë e shumicës myslimane dhe tek ortodoksët një favorizim të hapur të popullsisë katolike. Kjo ngjalli pakënaqësi te drejtuesit e Kishës dhe disa klerikë, që ardhjen e ushtrisë italiane në Shqipëri e kishin pritur me shumë entuziazëm. Kështu, delegati apostolik, Nigris ankohej se, në gjendjen e re politike nuk po tregohej një përkrahje e mjaftueshme nga ana e italianëve për pakicën katolike. Një qëndrim i tillë binte ndesh me strategjinë e qeverisë italiane e cila përpiqej, të paktën në dukje, të ndërtonte një ekuilibër të brendshëm dhe të fitonte simpatinë e të gjitha komuniteteve fetare. Mëkëmbësi i Përgjithshëm, Francesco Jacomoni, i shkruante eprorëve të tij se “imzot Nigris nuk do të kujtohet për faktin se Italia nuk mund e nuk duhet të paraqitet në Shqipëri si mbrojtëse e Kishës dhe të ndihmojë haptas prozelitizmin [konvertimin] katolik. Arsyet politike janë të dukshme, jo vetëm, por kisha katolike, me urtësinë e saj mijëvjeçare, nuk do ta kërkonte kurrë një ndërhyrje të tillë, që do të dilte e dëmshme për rezultatin e fundmë që ajo do të arrijë. Baraspesha e arritur brenda shtetit mes tri feve nuk mund të turbullohet, dhe katolikët

<sup>15</sup> Roberto Morozzo della Rocca, *Nazione e religione in Albania (1920-1944)*, Bologna: Il Mulino, 1990, f.199.

<sup>16</sup> M. W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri (1919-1996) ...*, f.122.

<sup>17</sup> *Po aty*, f.123.

hë për hë duhet të jenë të kënaqur që kanë një mbrojtje e një liri që në të kaluarën u ka munguar shpesh-herë”.<sup>18</sup>

Por xhelozia e klerit katolik ndaj kujdesit që autoritetet italiane tregonin ndaj shumicës myslimane erdhi duke u shtuar. Delegati apostolik, Leon Nigris i shkruante ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë se kleri e ndiente veten të lënë pas dore nga Mëkëmbësi, duke pasur përshtypjen se “vlerësohej pak në krahasim me simpatitë e shumta që shfaqeshin haptazi për myslimanët e pabesë”.<sup>19</sup>

Drejtuesit e klerit kishin kohë që i kërkonin Italisë të financonte ndërtimin e një katedraleje katolike në Tiranë. Kjo kërkesë pas 7 prillit gjeti edhe miratimin e Romës, e cila në kuadër të një projekti parashikonte që të pajiste kryeqytetin me tre tempuj të mëdhenj, që të përfaqësonin tri bashkësitë fetare. Por asgjë nuk u bë nga Jacomoni, që i nxori pengesa të ndryshme teknike e burokratike projektit të miratuar nga Roma.

Pak javë pas agresionit italian eksponentët më të lartë të bashkësisë katolike shqiptare e shprehën zyrtarisht pëlqimin e tyre për regjimin e ri. Më 4 maj 1939 të gjithë ipeshkvijt katolikë të Shqipërisë, përfaqësuesi françeskan dhe rektori i Kolegjit Jezuit të Shkodrës, vizituan Jacomoni-n për të shprehur ndjenjat e besnikërisë së tyre ndaj Vittorio Emanuele-t III dhe Duçes dhe për të komunikuar kënaqësinë e tyre të plotë për gjendjen e re të krijuar në vend. Argjipeshkvi Thaçi, duke folur në emër të të gjithëve, deklaroi se kishte besim që, nën mbrojtjen e Italisë, Shqipëria më së fundi do ta kishte të garantuar zhvillimin e vet shoqëror, ekonomik dhe shpirtëror.<sup>20</sup> Konsullata italiane e Shkodrës e komentonte këtë akt, duke nënvizuar se, ai ishte kushtëzuar nga dhënia e sigurimeve paraprake, se ligjet themelore nuk do të ndryshonin pa pasur parasysh nevojat e Kishës dhe pa dëgjuar mendimet e ipeshkvijve. Katolikët shfaqnin njëfarë nostalgjie për pavarësinë e humbur, por, shtonin me optimizëm autoritetet konsullore, ky ishte një element i papërfillshëm.<sup>21</sup> Më 12 prill

<sup>18</sup> *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*, Romë), Serie: Affari Politici (1931-1945), Busta 43. Telegram i Francesco Jacomoni-t, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 31 dhjetor 1939.

<sup>19</sup> R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania (1920-1944) ...*, f.199.

<sup>20</sup> *AMAE*, Romë, Serie: Affari Politici (1931-1945), Busta 43. Telekspres i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 6 maj 1939.

<sup>21</sup> *Po aty*. Telekspres i nënsekretarit të shtetit për punët shqiptare, për ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 10 qershor 1939.

Ciano shkruan se kishte ndier një mëri të madhe nga ana e katolikëve dhe klerit ndaj sulmit italian. Atë ditë në Tiranë po diskutohej lidhur me formën që do të lidhte Shqipërinë me Italinë. “Por gjërat nuk po shkojnë si në vaj, siç dukej. Ka shumë kundërshtime ndaj bashkimit personal... e kuptojnë se dhënia e kurorës Vittorio Emanuele-t III do të thotë të shënosh fundin e pavarësisë shqiptare. Kam diskutuar gjatë me shumë nga krerët: më të ashpër janë shkodranët e nxitur nga kleri katolik, i cili megjithatë bindet lehtë porsa shpërndaj pakot me franga shqiptare, që i mora me vete për çdo rast...”<sup>22</sup> Kur mori vesh për ardhjen e Ciano-s, delegati apostolik Nigris, u kujdes që të mos ndodhej në Tiranë, me pretekstin e angazhimit nëpër rrethe, që nuk shtyheshin dot, në mënyrë që ta takonte ministrin italian në mbrëmje, privatisht, që askush të mos dyshonte se ai dhe Selia e Shenjtë distancoheshin nga agresioni italian. Ai e kishte përjetuar 7 prillin si një ditë të mbrapshtë. Agresioni italian vlerësohej prej tij si një “krim” i vërtetë, përveçse si një gabim tragjik për vetë atdheun e tij, Italinë.<sup>23</sup>

Në krye të qëndrësës pasive ishin françeskanët, disa prej të cilëve krijuan një “celulë antifashiste”, e cila sipas një raporti të konsullit italian në Shkodër, Meloni, u mposht falë arrestimeve, pezullimit të ndihmave ekonomike ndaj urdhrit fetar, transferimeve të detyrueshme, arratisjes së ndonjë kleriku në Jugosllavi apo ndërprerjes për pak kohë të revistës *Hylli i Dritës*.<sup>24</sup> Në shkollat e drejtuara nga françeskanët dhe të motrave stigmatine të lidhura me to, shfaqeshin, sipas autoriteteve italiane, “ndjenja nacionalizmi të ekzagjeruar, antipatie dhe urrejtje ndaj Italisë”.<sup>25</sup> Një nga fretërit që dallohej në këtë drejtim ishte patër Anton Harapi,<sup>26</sup> i cili pas 8 shtatorit 1943 do të jetë protagonist i skenës politike shqiptare përkrah gjermanëve. Por kishte dhe nga ata françeskanë si patër Bernardin Palaj, i cili në kundërshtim me udhëzimet e eprorëve që i kërkonin të qëndronte larg veprimtarive politike, u bë kapelan i milicisë

<sup>22</sup>*The Ciano Diaries 1939-1943: The Complete, Unabridged Diaries of Count Galeazzo Ciano, Italian Minister of Foreign Affairs, 1936-1943*, New York: Simon Publication: December 1, 1945, f. 283.

<sup>23</sup>R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania...*, f.213.

<sup>24</sup>AMAE, Romë, Serie: Sottosegretariato, Affari Albanesi, Pacco 57 (1934-1940). Telekspres i konsullit italian në Shkodër, Meloni, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 23 qershor 1939.

<sup>25</sup>*Po aty*, Serie: Sottosegretariato, Affari Albanesi, Pacco 57 (1934-1940). Telekspres i Jacomoni-t, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 21 qershor 1940.

<sup>26</sup>*Po aty*. Promemorie e Fishtës, shkurt ose mars 1940.

në Tiranë. Një tjetër protagonist shumë i rëndësishëm ishte at Gjergj Fishta, i cili para 7 prillit njihej si kundërshtar i italianëve. Ndërsa pas kësaj date ai u kthye në një bashkëpunëtor të ngushtë. Fishta, duke vepruar në mënyrë të ngjashme, në shumë drejtime, me kleriko-fashistët italianë, mendohej pa rezerva për një marrëveshje me fashizmin dhe për të mbështetur regjimin e ri shqiptar.<sup>27</sup> Sidoqoftë, sipas autoriteteve italiane midis katolikëve gjendeshin elementët më mosbesues, kundër të cilëve kërkoheshin vigjilencë e veçantë.<sup>28</sup> Për këtë, Jacomoni kërkoi moslargimin e delegatit apostolik, i cili konsiderohej si person i përshtatshëm për të qenë ndërmjetës me klerin katolik shqiptar. Ai ishte përkrahës i një vije mosangazhimi politik, ashtu siç rekomandohej, në parim, edhe nga Selia e Shenjtë. Autoritetet civile mund të gjenin një mirëkuptim më të madh tek ai se sa te disa klerikë vendas.<sup>29</sup> Por kjo nuk rezultoi një përfundim tepër i saktë. Delegati apostolik kur krahasonte regjimin zogist me atë italian, parapëlqente të parin, si për administratën civile më pak të korruptuar, ashtu dhe për politikën më të barabartë ndërmjet tri feve. Jacomoni, sipas gjykimit të tij ishte filomysliman.<sup>30</sup> Nigris kërkonte që Italia të merrte një rol më aktiv në përkrahje të pakicës katolike shqiptare. Nënshkrimi i një Konkordati sipas modelit që Italia kishte nënshkruar me Selinë e Shenjtë në vitin 1929, ishte hapi i parë që duhej bërë në këtë drejtim.<sup>31</sup> Në rast të kundërt, kishës katolike t'i sigurohej një status juridik përballë shtetit. Meqenëse italianët nuk i plotësuan kërkesat e tij, delegati apostolik kaloi në njëfarë opozite. Ai nuk linte rast pa u ankuar se katolikëve të Shqipërisë nuk u ishte dhënë e gjithë ajo pjesë, që, sipas tij, duhej të ishte një angazhim nderi për kombin e madh katolik, i cili tani kishte në dorë fatet e Shqipërisë.<sup>32</sup> Kjo pakënaqësi bëri që disa përfaqësues të klerit të bashkoheshin me lëvizjen nacionaliste të Ballit Kombëtar. Kur në fillim të 1942-së Balli rivuri në diskutim parimin e pritshmërisë të ruajtur deri atëherë dhe filloi të

<sup>27</sup> R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania...*, f.197-198.

<sup>28</sup> AMAE, Romë, Serie: Affari Politici (1931-1945), Busta 43. Telekspres i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 6 maj 1939

<sup>29</sup> *Po aty*. Telekspres i Jacomoni-t, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 1 shtator 1939.

<sup>30</sup> R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania...*, f.199.

<sup>31</sup> AMAE, Romë, Serie: Sottosegretariato, Affari Albanesi, Pacco 57 (1934-1940). Kërkesë e delegatit apostolik, Nigris, për Jacomoni-n, Tiranë, 1 tetor 1939.

<sup>32</sup> *Po aty*, Romë, Serie: Affari Politici (1931-1945), Busta 43. Telekspres i Jacomoni-t, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 31 dhjetor 1939.

sulmojë italianët, argjipeshkvi Thaçi dhe patër Anton Harapi shkuan te delegati apostolik, Nigris, në emër të klerikëve që ishin përfshirë në lëvizjen nacionaliste, për të shtruar çështjen nëse lejohej pjesëmarrja e klerit dhe e besimtarëve në luftën e armatosur që po fillonte. Ndër nacionalistët, i referuan ata delegatit, kishte dy parti, e moderuara që s'ishte për dhunën dhe ajo në favor të luftës së armatosur: ç' duhej bërë? Nigris u përgjigj se, sipas direktivave të Selisë së Shenjtë, kleri nuk duhej të merrte pjesë as në njërin as në tjetrin drejtim të rezistencës kundër italianëve, meqenëse ai ishte i ngarkuar me një mision kryesisht fetar: për sa u përkiste klerikëve, atyre mund t'u sugjerohej që të merrnin pjesë në rrymën nacionaliste e të moderuar, sepse, *ex natura rei* (sipas natyrës së gjërave) duhej përjashtuar dhuna.<sup>33</sup>

Ky qëndrim i klerit katolik bëri që italianët t'i kanalizonin aspiratat nacionaliste në një drejtim të favorshëm për ta, duke u bërë flamurtarë të rivendikimeve territoriale shqiptare ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë. Një pamflet i françeskanit Marin Sirdani, i shtypur më 1941 në Tiranë, përbën një traktat të vogël që është një shembull për joshjen që ushtronte kjo lloj politike italiane.<sup>34</sup> Subvencionet për klerin erdhën duke u rritur deri në momentin e kapitullimit të Italisë. Në fund të vitit 1941, qeveria shqiptare i akordoi dymbëdhjetë Enteve Kishtare Katolike një subvencion të veçantë për të cilin Kryeministri Shefqet Vërlaci njoftoi delegatin apostolik të paraqiteshin në degën e Bankës Kombëtare për të tërhequr çeqet e akorduara.<sup>35</sup>

#### *Subvencion i Enteve Kishtare Katolike*<sup>36</sup>

Nr.	Enti katolik	Shuma e akorduar në franga shqiptare
1	Administratës apostolike të Shqipërisë së Mesme	25 000
2	Arkidioqezës së Shkodrës	12 000
3	Arkidioqezës së Durrësit	12 000
4	Dioqezës së Mirditës	9 000
5	Dioqezës së Sapës (Zadrimës)	9 000
6	Dioqezës së Lezhës	5 000

<sup>33</sup> R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania...*, f.201.

<sup>34</sup> Marin Sirdani, *Shqypnija e shqyptarët*, Shkodër: Shtypshkronja "A. Gj. Fishta", 1941, f.4.

<sup>35</sup> *AQSH*, F. 155, V. 1941, D. VIII-498, fl. 21-22. Letër e Kryeministrit Shefqet Vërlaci, për delegatin apostolik në Shkodër, Tiranë, 14 nëntor 1941.

<sup>36</sup> *Po aty*.



7	Dioqezës së Pultit	4 000
8	Provincës françeskane	17 000
9	Misionit shëtitës	4 000
10	Seminarit të Shkodrës	10 000
11	Motrave stigmatine	3 000
12	Motrave servite	2 000

Në përgjithësi subvencionet ndaj klerit nuk shpërndareshin nëpërmjet hierarkisë kishtare, por sipas dëshirës së Jacomoni-t, i cili, meqenëse kisha katolike nuk gëzonte personalitet juridik, i kërkoi qeverisë shqiptare të mos parashikonte asnjë zë për subvencionimin e saj në buxhet. Ai përpigëj t'i komprometonte klerikët me anë të joshjes financiare.<sup>37</sup>

Marrëdhëniet e delegatit apostolik, Nigris dhe Jacomoni-t u tensionuan edhe për një arsye tjetër. Lëvizja uniatiste që vepronte në Shqipërinë e Jugut mund të prishte baraspeshën fetare dhe të krijonte incidente e pakënaqësi ndaj italianëve. Prandaj, Jacomoni e kërcënoi delegatin se po të prishnin qetësinë publike misionarët do të arrestoheshin.<sup>38</sup>

Ndonëse marrëdhëniet e katolikëve shqiptarë dhe një pjese të klerit njohën faza të alternuara, në korrik të 1943-shit, kur Italia fashiste ishte në prag të kapitullimit, sipas Jacomoni-t, në Shkodër propaganda antiitaliane në gjirin e mjedisit katolik vazhdonte. Argjipeshkvi i Shkodrës ishte vendosmërisht kundër italianëve dhe ndikonte në këtë drejtim tek elementi katolik, duke ngjallur shqetësim të madh te delegati apostolik.<sup>39</sup>

Në prill 1943 provinciali françeskan patër Anton Harapi ishte i bindur se fuqitë e Boshtit do ta humbnin luftën përballë aleatëve anglo-amerikanë. Ai kërkoi nga at Pal Dodaj, që në konfliktin që kishte filluar mes Kryeministrit Maliq Bushati dhe ministrit të Brendshëm, Mark Gjon Markaj të ndërmyjetësonte për ta tërhequr këtë të fundit në partinë e Mid'hat Frashërit dhe Hasan Dostit, të cilët mbaheshin si përfaqësues të nacionalizmit të kulluar dhe ta shkëpuste nga Mustafa Kruja, që ishte për bashkimin e dy kurorave (Shqipërisë me Italinë). Në tri takimet që at Pali

<sup>37</sup> R. M. della Rocca, *Nazione e religione in Albania...*, f. 202-203.

<sup>38</sup> *Po aty.*

<sup>39</sup> *AMAE*, Romë, Serie: Affari Politici (1931-1945), Busta 45. Telekspres i ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 24 gusht 1943.

zhvilloi me ministrin e Brendshëm, Mark Gjon Markaj, konstatoi se ky ishte shumë i preokupuar për të shpëtuar imazhin nacionalist të fretërve në sytë e opinionit publik. Ai nisej nga perspektiva që dukej në horizont, se Boshti kishte për ta humbur luftën. At Pali shprehte rezerva se Mark Gjon Markaj, nuk kishte mbajtur dinjitetin e mjaftueshëm dhe i frikësohej faktit se do të përfundonte duke komprometuar veten dhe provincën.<sup>40</sup> Në këtë periudhë ndërmjet drejtuesve të klerit katolik kishte filluar një përplasje e brendshme lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur në raport me rrethanat e reja që po krijoheshin.<sup>41</sup> Kjo vinte për shkak të humbjeve të njëpasnjëshme të Italisë në LDB dhe të pakënaqësisë që administrata dhe oficerët e saj kishin krijuar te kleri katolik shqiptar. Qëndrimi që duhej mbajtur e kishte ndarë klerin në dy grupime: në përkrahës dhe në kundërshtarë të Italisë. Një arsye themelore për këtë ishte përpjekja e ushtarakëve italianë për ta instrumentalizuar klerin katolik shqiptar në funksion të luftës dhe interesave politike që ata ndiqnin në Shqipëri.

Kjo vihet re edhe nga audienca që at Pali pati me gjeneral Parianin më 8 korrik 1943, i cili në funksion të përndjekjes që do t'i bënte lëvizjes antifashiste i deklaroi priftit katolik se për të zbuluar bazat e tyre do të mbyllte për një vit të gjitha shkollat, dhe se do të hakmerrej me të njëjtën masë që “rebelat e Toskënisë” kishin treguar ndaj ushtarëve italianë. Gjeneral Pariani mori shënim kërkesën e at Palit lidhur me shkollën e Gomsiqes (Pukë) dhe për tokën që do t'i jepte afër asaj që u ishte dhënë murgeshave stigmatine. Kur po dilte nga takimi, at Pali me një gjuhë diplomatike i deklaroi gjeneral Parianit: “Shkëlqesë, në anët tona do të vazhdojmë në misionin tonë të paqëtimit e të qetësisë”. Por reagimi i tij që i menjëhershëm “Nuk mjafton, - ia preu ai, - duhet të merrni bastunin edhe pushkën!”<sup>42</sup> Në këtë takim gjeneral Pariani i tregoi at Palit për krijimin e një formacioni të ri politik, i cili do të kishte në themel të tij parimin e bashkimit të Shqipërisë me Italinë. “Do të mbyllim gojën për fashizmin dhe do të krijojmë një parti të re me parrullën «Për Shqipërinë, me Italinë»”<sup>43</sup>.

<sup>40</sup> *AQSH*, F. 734, D. 164/1. Pjesë nga ditari i at Pal Dodaj, shënim i datës 20 prill 1943. (Ditari është pa sinjaturë prandaj do të citohet vetëm data dhe jo numri i fletës.)

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> *Po aty*, shënim i datës 8 korrik 1943.

<sup>43</sup> *Po aty*.

### **Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit gjerman (1943-1944)**

Afrimi i fundit të sundimit të Italisë fashiste krijoi një situatë të mjegullt për orientimin e klerit katolik. Sipas at Palit në Shkodër nuk flitej për asgjë tjetër dhe të gjithë ishin të preokupuar për fatet e vendit dhe për gjendjen e tij të tanishme. Argjipeshkvi ftoi të gjithë krerët katolikë, provincialin françeskan dhe kapidan Marka Gjonin për të diskutuar rreth situatës së krijuar. Të nesërmen do të ftoheshin në takim edhe krerët myslimanë të qytetit.<sup>44</sup>

Në fillim të muajit gusht kleri katolik zhvilloi disa takime. Ai bëri një përpjekje për organizimin e një kuvendi, por situata e nderë dhe lajmet që vinin për shpartallimin e ushtrisë italiane nga lëvizja antifashiste ngjalli pasiguri dhe panik.<sup>45</sup> Më 6 gusht 1943 në oborrin e kishës së Shkodrës u paraqitën 10 partizanë, dy prej të cilëve hynë brenda dhe i deklaruan at Palit se ishin të vendosur të sulmonin italianët për të merituar konsideratat dhe që fituesit anglo-amerikanë e rusët të merrnin parasysht fatet e Shqipërisë së pasluftës. Kleriku katolik u përpoq t'u shpjegonte që "të hiqnin dorë nga kjo marri, duke i sjellë vendit fatin e Toskërisë e duke kthyer atë në krater vullkanik". Por, njëri nga partizanët i deklaroi se, personalitete të shquara të Tiranës tashmë kishin dalë në mal, dhe se të gjitha grupimet politike të Shkodrës ishin bashkuar.

Shpërndarja e milicisë, ushtrisë dhe xhandarmërisë pas kapitullimit të Italisë rritej nga dita në ditë. Kjo i dha mundësi lëvizjes komuniste që të zgjeronte influencën e saj, duke pretenduar që t'i zinte vendin Italisë. Ata merrnin si shembull luftën e bolshevikëve për mbrojtjen e aspiratave të popullit rus. Sipas at Palit, komunistët shqiptarë niseshin nga dy pika: *e para*, Boshti kishte për ta humbur luftën, *e dyta*, nëse nuk do të luftohej tani kundër Boshtit, ditën e fitores nga aleatët, nuk do të mundej të ngrihej zëri për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve.<sup>46</sup>

Qëndrimi i klerit katolik në këto momente, me përjashtim të ndonjë prifti si dom Zef Shestani dhe disa djelmosha që dolën në mal me forcat e Ballit Kombëtar, ishte i papërcaktuar. Ky qëndrim kritikohet nga

<sup>44</sup> *Po aty*, shënim i datës 26 korrik 1943.

<sup>45</sup> *Po aty*, shënim i datës 3 gusht 1943.

<sup>46</sup> *Po aty*, shënim i datës 6 gusht 1943.

provinciali françeskan patër Antoni, i cili deklaronte se “ne po inkriminohemi se nuk po bëjmë kurrë. Na ka ba shumë dam. Shqipnia asht çue në kambë. Na nuk dijmë se kah po rrijmë”. Nga njëra anë, kleri katolik kritikohej nga delegati apostolik dhe kapidan Gjon Marka Gjoni në qarqet e larta drejtuese si antiitalianë, ndërsa nga ana tjetër Balli Kombëtar dhe komunistët protestonin kundër tyre se ndiqnin një politikë filoitaliane. Prandaj, patër Antoni, i përmbahej parimit për bashkimin e popullit, disiplinë, qetësi dhe përgatitje për çdo eventualitet.<sup>47</sup>

Në këtë situatë, gjeneral Pariani kërkoi nga argjipeshkvi i Shkodrës, të mos organizohej asnjë mbledhje civile apo lëvizje që binte në kundërshtim me pozitën e ushtrisë italiane të mbetur në Shqipëri.<sup>48</sup> Paria e disa fshatrave katolike të Shkodrës lidhi besën për të mos lejuar futjen e komitëve (partizanëve) dhe për mos të mos u dhënë ushqime apo çfarëdolloj ndihme. Nëse dikush prej tyre mësynte në shtëpitë e fshatarëve, ata duhej të lajmëronin menjëherë organet e qeverisë. Për këtë besëlidhje, at Pali lajmëroi me një letër kapidan Marka Gjoni dhe komandantin e ushtrisë italiane të sektorit Shkodër-Kosovë, gjeneral Paride Negri-n.<sup>49</sup> Ky i fundit e falënderonte at Palin për bashkëpunimin dhe i premtonte se do të merrte në konsideratë kërkesën për mbështetje të armatosur.<sup>50</sup>

Kjo lidhje e disa përfaqësuesve të klerit katolik me drejtuesit e ushtrisë italiane që ndodhej në zgrip vazhdoi deri në fillim të shtatorit 1943. Kështu, at Palit që gjendej në vështirësi ekonomike, i mbërriti më 3 shtator një çek me 1 000 fr. ari nga Mëkëmbësia që mbante firmën e gjeneral Parianit.<sup>51</sup> Para se të largohej nga Shqipëria, ai kishte kërkuar një audiencë me argjipeshkvin, të cilit i kishte lënë këtë testament: “Programi i shqiptarëve duhej të ishte që Shqipëria të mbetej gjithmonë një repart i pathyeshëm kundër bolshevizmit dhe sllavizmit”. Një ditë më parë ai kishte ftuar edhe provincialin françeskan, të cilit i kishte përsëritur të njëjtën këshillë se shqiptarët duhej të ruanin principin e independencës dhe që trupat italiane, të mos goditeshin pas shpine.<sup>52</sup>

<sup>47</sup> *Po aty*, shënim i datës 8 gusht 1943.

<sup>48</sup> *Po aty*, shënim i datës 9 gusht 1943.

<sup>49</sup> *Po aty*, shënim i datës 15 gusht 1943.

<sup>50</sup> *Po aty*, shënim i datës 22 gusht 1943.

<sup>51</sup> *Po aty*, shënim i datës 3 shtator 1943.

<sup>52</sup> *Po aty*, shënim i datës 8 shtator 1943.

Pas kapitullimit të Italisë, më 9 shtator 1943 u zhvillua një takim mes delegatit apostolik, Leone Nigris dhe argjipeshkvit Gaspër Thaçi, ku u vendos se duke bashkëpunuar me prijësit katolikë duheshin marrë të gjitha masat për parandalimin e marrjes së pushtetit nga komunistët. Kjo derisa të mbërrinin forcat gjermane dhe të stabilizohej situata politike brenda vendit.<sup>53</sup> At Anton Harapi dhe ish Kryeministri Maliq Bushati e shihnin si problem kryesor kaosin e krijuar në vend dhe vakuumin e pushtetit pas tërheqjes së Italisë. Në mesin e shtatorit, Shqipëria ishte një vend pa qeveri, por me kryengritës të organizuar mjaft mirë.<sup>54</sup>

Në këto rrethana, një pjesë e ushtarakëve italianë u bashkuan me forcat partizane për të luftuar kundër avancimit të trupave gjermane në territorin shqiptar; ndërsa në Dukagjin dhe Malësinë e Madhe u organizuan disa mbledhje të Ballit Kombëtar ku fretërit katolikë po merrnin pjesë aktive.<sup>55</sup> Drejtuesit e kishës dhe paria katolike ishin në një gjendje të vështirë. E ardhmja ishte krejtësisht e pasigurtë. Gjermanët, që tashmë kishin hyrë në kryeqytet, po përgatiteshin për mbledhjen e një asambleje të re, për të cilën kleri ishte i bindur se ata do të influenconin, që prej saj të dilte një qeveri sipas shijes së tyre.<sup>56</sup> Në qytete, sipas at Palit, veprimi i komunistëve që vrisnin dhe i detyronin të pasurit të paguanin ishte bërë e padurueshme. Në përgjithësi Malësia e Veriut, Malësia e Madhe, Dukagjini, Puka e Mirdita i përmbaheshin principit që të mos i sulmonin e të mos i shqetësonin trupat gjermane dhe të qëndronin jashtë partive subversive, veçanërisht asaj komuniste. Te kleri katolik ekzistonte frika se qeveria e re do të hakmerrej kundër njerëzve të regjimit të kaluar.<sup>57</sup>

Me instalimin e administratës ushtarake gjermane në Shkodër, argjipeshkvi Gaspër Thaçi dhe at Anton Harapi si provinciali françeskan në detyrë, kontaktuan menjëherë me gjeneralin SS Hausding për të diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e situatës. Për të mbajtur kontakte mes

<sup>53</sup> Rakip Beqaj, *Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik*, (Pjesa e parë) Tiranë: Naim Frashëri, 1969, f.165.

<sup>54</sup> M. W.E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri (1919-1996) ...*, f.137.

<sup>55</sup> *AQSH*, F.734, D.164/1. Pjesë nga ditari i at Pal Dodaj, shënim i datës 26 shtator 1943.

<sup>56</sup> *Po aty*, shënim i datës 27 shtator 1943.

<sup>57</sup> *Po aty*, shënim i datës 30 shtator 1943.

kishës katolike dhe komandës gjermane u caktua ati françeskan Mati Prendushi OFM.<sup>58</sup>

Më 10 tetor 1943, at Pali shkruan se në zyrën e provincialit françeskan kishte takuar Mehdi Frashërin, Mid`hat Frashërin dhe Hasan Dostin, që kishin ardhur nga Tirana. Provinciali i kishte treguar se së shpejti do të mblidhte ipeshkvijt, për të diskutuar lidhur me situatën e re që ishte krijuar brenda vendit.<sup>59</sup>

Paria katolike vendosi që, për interesat e vendit, të merrte pjesë në Asamblenë e 1943-ishit. Megjithatë ata nuk mendonin të merrnin pjesë në qeveri,<sup>60</sup> me përjashtim të provincialit françeskan, patër Anton Harapi që mori detyrën si anëtar i Regjencës,<sup>61</sup> duke ruajtur kështu traditën e krijuar nga Kongresi i Lushnjës me nga një përfaqësues për çdo komunitet.

Më 23 tetor patër Antoni u nis nga Shkodra drejt Tiranës me një avion gjerman. Në ditarin e tij, at Pali shkruan se nuk dihej nëse ai do ta pranonte këtë detyrë pa lejen e Selisë së Shenjtë, duke pasur njëkohësisht funksionin e provincialit françeskan. Por emërimi i tij vërtetonte, sipas at Palit, mosbesimin që kishin tek ai njerëzit e regjimit të kaluar, domethënë, bashkëpunëtorët e Italisë fashiste.<sup>62</sup> Por edhe pater Antoni kishte rezerva kundrejt at Palit, të cilit i kërkonte më 10 nëntor 1943, me cilësinë e anëtarit të Regjencës dhe jo si OFM, që ta takonte në Shkodër.<sup>63</sup>

Më 11 nëntor, provinciali françeskan patër Antoni thirri në Kuvendin e Gjuhadolit për konsultim të gjithë klerikët e provincës. Ai kërkoi mendimin e tyre për zgjedhjen si anëtar i Regjencës. Sipas at Palit, tek provinciali vihej re kënaqësia dhe vendimi i patundur për t`u bërë pjesë e Regjencës, duke mos marrë parasysh rrezikun për jetën. Për pjesën më të madhe të pranishmëve në këtë mbledhje, ky rrezik krijonte të vetmen pengesë, ndërsa në fakt, thekson at Pali, nuk ishte vetëm ky. Kleri katolik, duke marrë në konsideratë perspektivën e forcave të Boshtit, ishte i vetëdijshëm për pasojat që mund të kishte pas përfundimit të

<sup>58</sup> R. Beqaj, *Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik ...*, f.201.

<sup>59</sup> *AQSH*, F.734, D.164/1. Pjesë nga ditari i at Pal Dodaj, shënim i datës 10 tetor 1943.

<sup>60</sup> *Po aty*, shënim i datës 15 tetor 1943.

<sup>61</sup> “U zgjodh Këshilli i Naltë i Regjencës me misa shkëlqesat M.Frashëri, F.Dibra, L.Nosi, A.Harapi”, *Kombi*, nr.16, Tiranë: 23 tetor 1943, f. 1.

<sup>62</sup> *AQSH*, F. 734, D. 164/1. Pjesë nga ditari i at Pal Dodajt, shënim i datës 23 tetor 1943.

<sup>63</sup> *Po aty*, shënim i datës 10 nëntor 1943.

luftës. Prandaj, ai i trembej implikimit të mëtejshëm në organet drejtuese të qeverisë kuislinge të krijuar nga gjermanët.

Në këtë takim, pater Antoni lexoi dhe përktheu nga gjermanishtja instruksionet e Selisë së Shenjtë lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur. Sipas saj, kleri katolik duhej t'i përmbahej pëlqimit të argjipeshkvit të Shkodrës. Ai lexoi edhe letrën që kryetari i Asamblesë, Lef Nosi, i kishte drejtuar kardinal Maglione-s (Maljone-s) dhe gjeneralit të Urdhrit Françeskan, ku i lutej që të aprovonin kërkesën që pater Antoni të pranonte funksionin e anëtarit të Regjencës. Argjipeshkvi Thaçi ishte shumë i shqetësuar për emërimin e një kleriku katolik në Regjencë dhe e kundërshtonte këtë. Ai nuk kishte ndërmend të jepte pëlqimin e tij pa atë të ordinarëve. Ndërsa nga ana tjetër, kishte frikë se me qëndrimin e tij negativ, do të ndeshet me zemërimin e shtetit dhe të komandës gjermane. Edhe argjipeshkvi i Durrësit, Mati Prendushi i kishte kërkuar pater Antonit që të largohej nga Tirana, duke e qortuar për pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Regjencës pa mbërritur përgjigjja e Selisë së Shenjtë që e miratonte këtë vendim.<sup>64</sup>

Argjipeshkvi Thaçi ankohej për pater Anton Harapin që nuk e kishte vendosur në dijeni për zgjedhjen e anëtarëve të Regjencës. Argjipeshkvi kishte frikë nga një reprezalje e anglo-amerikanëve kundër Shkodrës dhe katolikëve për shkak të implikimit të patër Antonit si anëtar i Regjencës. Kjo tregon qëndrimin e dyzuar të drejtuesve të klerit katolik rreth çështjes nëse duhej ose jo të përfshiheshin në organet drejtuese të shtetit shqiptar gjatë pushtimit gjerman.<sup>65</sup>

Pater Antoni me gjithë kundërshtimin e imzot Thaçit, për emërimin e tij si anëtar i Regjencës, ishte i vendosur për ta pranuar këtë detyrë dhe i lexoi at Palit një pjesë nga letra që i kishte dërguar argjipeshkvit duke shtuar “aq ma mirë nëse argjipeshkvi nuk ma lejon, por e gjithë përgjegjësia do të bjerë mbi të”.<sup>66</sup> Ai mendonte se, nëse ai do të tërhiqej nga Regjenca, ekzistonte rreziku që edhe anëtarët e tjerë të tërhiqeshin dhe vendi do të hynte në kaos. Ndërsa kapiteni Mark Gjonmarkaj, e vlerësonte kundërshtimin e argjipeshkvit si xhelozit groteske kundër fretërve françeskanë.<sup>67</sup>

<sup>64</sup> *Po aty*, shënim i datës 11 nëntor 1943.

<sup>65</sup> *Po aty*.

<sup>66</sup> *Po aty*.

<sup>67</sup> *Po aty*.

Krerët katolikë të Mirditës dhe të Malësisë së Madhe ishin të vendosur që të bashkëpunonin me popullsinë myslimane për të lidhur besën me qëllim për të penguar hyrjen e forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në krahinat e tyre. Më 12 nëntor u mbledh në Koplik e gjithë Malësia e Madhe, ku u betua për të mos lejuar hyrjen e asnjë komunisti.<sup>68</sup>

Më në fund, i ndodhur nën presionin e rrethanave politike, argjipeshkvi Thaçi vendosi që t'i jepte leje me shkrim patër Antonit, për t'u bërë pjesë e Regjencës.<sup>69</sup> Betimi i tij para Parlamentit u bë më 13 janar 1944, ku ai mbajti një fjalim të famshëm me theks nacionalist me titull "*T'a bajmë monument kombtar: Bashkimin e Shqiptarvet*".<sup>70</sup>

Në këtë fjalim, ai argumenton vendimin e tij për të marrë pjesë në Regjencë. Arsyeja kryesore ishte vendosja e rendit shtetëror pas kapitullimit të Italisë. Më 17 qershor 1944, ai u zëvendësua si provincial i françeskanëve nga Mati Prendushi dhe, brenda një kohe të shkurtër, u tërhoq nga të gjitha funksionet fetare.<sup>71</sup>

Në periudhën e pushtimit gjerman, kisha katolike vazhdoi të ushtronte lirisht veprimtarinë dhe misionin e saj apostolik. Qeveria shqiptare, ashtu si për të gjitha komunitetet fetare, lejoi që një pjesë e klerit të jepte në shkollat e shtetit lëndën e mësim-besimit. Kështu, zyra famullitare njoftoi Ministrinë e Drejtësisë dhe Inspektorinë e Arsimit se për dhënien e kësaj lënde në shkollat fillore të kryeqytetit kishte caktuar dom Anton Doçin<sup>72</sup> dhe dom Frano Iliaj.<sup>73</sup>

Këto qëndrime të klerit katolik gjatë viteve të luftës u shfrytëzuan pas vendosjes së regjimit komunist që ai të akuzohej si kolaboracionist dhe një pjesë prej tyre të ekzekutohej, internohej dhe të merrte dënime tepër të rënda.

<sup>68</sup> *Po aty*, shënim i datës 15 nëntor 1943.

<sup>69</sup> *Po aty*, shënim i datës 27 nëntor 1943.

<sup>70</sup> *T'a bajmë monument kombtar: Bashkimin e Shqiptarvet - fjalim me rasen e betimit përpara Parlamentit*, Tiranë: Shtypshkronja Shtetërore Shqiptare, 1944.

<sup>71</sup> M. W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri (1919-1996)*..., f.143.

<sup>72</sup> *AQSH*, F. 155, V. 1944, D. VIII-554, fl. 1. Letër e famullitarit dom Shtjefën Kurti, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 15 prill 1944. *AQSH*, F. 155, V. 1944, D. VIII-554, fl. 1. Letër e famullitarit dom Shtjefën Kurti, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 15 prill 1944.

<sup>73</sup> *Po aty*, fl.2. Letër e famullitarit dom Shtjefën Kurti, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 4 tetor 1944.



*S u m m a r y*

## THE CATHOLIC CHURCH DURING THE SECOND WORLD WAR PERIOD

The relations of the clergy and the Albanian Catholic Church with fascist Italy and after its capitulation with Nazi Germany and the quisling administration of the time must be analyzed case by case. This is because not all Catholic clergy have held the same position. While some of them welcomed the arrival of the Italian army, the rest viewed it with displeasure. These findings are also noted in the reports of senior leaders of the Italian administration and army in Albania. Therefore the whole clergy cannot be accused of collaborating with fascist Italy. The same situation applies to the period of German occupation.

However, the involvement of some clerics with the Italian and German occupiers during the Second World War would cost them dearly after the establishment of the communist regime. Many of them will be accused of collaborating with the invaders and will receive extremely severe punishments.

